

FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data : 02.05.2017]

Për: Operatorin Ekonomik “Kevin Konstruksion” shpk

Procedura e prokurimit: **“Tender i Hapur”** me objekt : **“Rruga Borje – Kufi me Kosoven”**.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Rruga Borje – Kufi me Kosoven”**.

Kohëzgjatja: brënda 8 muajsh nga data e fillimit te punimeve.

Fondi limit: 62.301.000 (gjashtëdhjetë e dy milion e treqind e një mijë) Lekë pa TVSH.

Fondi i akorduar për vitin 2017 është 12.500.000 (dymbëdhjetë milion e pesëqind mijë) lekë pa tvsh. Pjesa e mbetur është parashikuar për vitin 2018.

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **Datë 17.03.2017.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Nuk ka patur.

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh:

Nr	Shoqëria	Oferta lek pa tvsh para kontrollit aritmetik
1	Company Riviera 2008	47,609,092
2	Kacdedja	49,840,802
3	RSM Company	50,895,056
4	Mela & Albshpresa	52,000,000
5	Kevin Konstruksion	53,317,647
6	Be – IS	54,224,062
7	Boshnjaku B	57,890,968
8	Lala & Shansi Invest & Jody	60,007,535
9	Çaushi	Nuk ka paraqitur oferte
10	Varaku E	Nuk ka paraqitur oferte

Pas vleresimit te dokumentacionit te paraqitur komisioni me unanimitet vendosi:

1. Te skualifikoje shoqerine “Company Riviera 2008” shpk per arsye se:

Referuar deklaratës se punëve në proces rezultoi se shoqëria “Company Riviera 2008” shpk ka në proces punë me një vlerë të përgjithshme prej 229.425.750 leke pa tvsh. Këto punë konsistojnë në rivitalizime urbane dhe rikonstruksione rrugësh. Kjo shoqëri zotëron pikën e licencës NP-4C e cila i lejon të kryejë në të njëjtën kohë punime me vlerë të përgjithshme jo më shumë se 100.000.000 leke.

Në datën 04.04.2017 KVO i dërgoi një kërkesë ku kërkohej informacion për punët e deklaruara në proces. Kjo shoqëri deri tani nuk ka dërguar asnjë përgjigje. Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr 42, datë 16.01.2008, Kreu III, pikë 1, paragrafi IIb kjo shoqëri duhet të skualifikohet.

2. Te skualifikojë shoqërinë “Kacdedja” shpk për arsye se:

Nuk plotëson pikën 2.3.1 të Kërkesave të Vecanta për Kualifikim lidhur me punët e ngjashme, pasi për të provuar realizimin e punëve të ngjashme ka paraqitur dokumentacion për realizimin e disa objekteve me vlerë totale të realizuar në tre vitet e fundit 29.643.878 leke nga 124.602.000 leke që duhet të ishte për të përmbyshur kushtin. Objekti ndërtim shkolle nuk është llogaritur pasi nuk mund të konsiderohet si punë e ngjashme.

3. Te skualifikojë shoqërinë “Ruge, Sinjalistike, Mirembajtje & Hidro Company” shpk për arsye se:

Nuk plotëson pikën 2.2.4 të Kërkesave të Vecanta për Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar punëve në proces të deklaruara, ka kryer aktivitet në Korce nga data 01.06.2016 e në vazhdim dhe nuk ka paraqitur dokumentacion për shlyerjen e detyrimeve vendore.

Nuk plotëson pikën 2.3.1 të Kërkesave të Vecanta për Kualifikim lidhur me punët e ngjashme, pasi për të provuar realizimin e punëve të ngjashme ka paraqitur dokumentacion për realizimin e objektit “Ndërtimi i rrugës “Ahmet Krasniqi””. Ky objekt është kollauduar në datën 12.08.2013, jashtë afatit 3 vjeçar të kërkuar në kërkesën për kualifikim dhe, në këtë mënyrë, nuk plotëson kushtin.

4. Te skualifikojë bashkimin e perkohshëm të shoqërive “Mela” shpk dhe “Albshpresa” shpk për arsye se:

Shoqëria “Mela” shpk nuk plotëson pikën 2.3.3 për kualifikim lidhur me stafin e nevojshëm pasi nuk ka paraqitur dokumentacion për një inxhinier hidroteknik, ndërkohë që ka marrë persiper të kryejë punime kanalizimesh, për kryerjen e të cilave ky specialitet është i domosdoshëm.

Shoqëria “Mela” shpk nuk plotëson pikën 2.3.3 për kualifikim lidhur me stafin e nevojshëm pasi nuk ka paraqitur dokumentacion për një inxhinier topograf, ndërkohë që ka marrë persiper të kryejë punime kanalizimesh dhe punime për shtresat rrugore, për kryerjen e të cilave ky specialitet është i domosdoshëm.

Shoqëria “Mela” shpk nuk plotëson pikën 2.3.3 për kualifikim lidhur me stafin e nevojshëm pasi nuk ka paraqitur dokumentacion për një inxhinier elektrik, ndërkohë që ka marrë persiper të kryejë punime elektrike, për kryerjen e të cilave ky specialitet është i domosdoshëm.

Shoqëria “Mela” shpk nuk plotëson pikën 2.3.6 për kualifikim lidhur me pikat e nevojshme të licencës pasi ka marrë persiper punime shtresash rrugore dhe nuk ka pikën e licencës NS18 (punime topogjeodezike). Po ashtu ka marrë persiper punime elektrike dhe nuk ka pikën e licencës NP 11.

Duke qenë se këto të meta janë thelbësore, komisioni vendosi të mos vazhdojë me me shqyrtimin e dokumentacionit të mbetur për këtë bashkim shoqëri.

5. Te skualifikoje shogerine “Be - Is” shpk per arsye se:

Shoqeria “Be-Is” shpk nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar, kryen aktivitet ne Durres, Librazhd dhe Vlore nga viti 2016 e ne vazhdim dhe nuk ka paraqitur dokumentacion per shlyerjen e detyrimeve vendore. Per rrjedhoje edhe deklarata e paraqitur ne perputhje me kriterin 2.2.5 per kualifikim rezulton te jete e rreme.

6. Te skualifikoje shogerine “Boshnjaku B” shpk per arsye se:

Nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar, kryen aktivitet ne Gjirokaster nga viti 2016 e ne vazhdim dhe nuk ka paraqitur dokumentacion per shlyerjen e detyrimeve vendore.

7. Te skualifikoje shogerine “Caushi” shpk e cila nuk ka paraqitur oferte.**8. Te skualifikoje shogerine “Varaku E” shpk e cila nuk ka paraqitur oferte.****Te konsideroje te kualifikuara shogerite:**

“Kevin Konstruktion” shpk

“Lala” shpk & “Shansi Invest” shpk & “Jody” shpk

Komisioni kontrolloi per gabime aritmetike dhe konstatoi se nuk ka gabime.

Komisioni kontrolloi per oferta anomalisht te uleta dhe konstatoi se nuk ka oferta anomalisht te uleta.

Ne perfundim komisioni vendosi te beje renditjen si me poshte:

NR	OPERATORI EKONOMIK	OFERTA PA TVSH	RENDITJA
1	“Kevin Konstruktion” shpk	53.317.647	RENDITET NE VEND TE PARE
2	“Lala” shpk & “Shansi Invest” shpk & “Jody” shpk	60.007.535	RENDITET NE VEND TE DYTE

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin ekonomik “Kevin Konstruktion” shpk se oferta e paraqitur, me vlerë **53.317.647 (pesedhjetë e tre milion e treqind e shtatëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e shtatë)** lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoritetit Kontraktor:**

- **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
- **Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 10, Tirana, Albania**
- **Phone: 00355 4 2 235 597/8 (int.151)**
- **Fax: 00355 4 2 234 885**

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda pese ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **24.04.2016**.

Ankesa nuk ka patur.

